



PRIVATE SECTOR PARTNERSHIPS TO STRENGTHEN HIGHER EDUCATION

Përmbledhje e Diskutimit

Bordi Industrial i Fakultetit të Shkencave Kompjuterike
11 Prill, 2024, Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti", Salla e Senatit

Agjenda

10:00 - 10:10: Mirëseardhje

Dr. Zirije Hasani, Dekane e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike, Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti"

10:10-10:30: Prezentimi i anëtarëve të rinj

Dr. Zirije Hasani, Dekane e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike

10:30-10:45: Prezantim i shkurtër rreth projektit *Private Sector Partnership to Strengthen Higher Education*
Prezantimi nga: Getoar Krasniqi, Specialist i Marrëdhënieve me Industrinë e TIK

10:45-11:00: Votimi i udhëheqësisë së re të Bordit Industrial

Pikat e Diskutimit

Zirije Hasani: "Jam e kënaqur sidomos për vitin e fundit për punën që është bërë dhe e falënderoi shumë Enisin, dhe ai është shprehur i gatshëm gjithmonë të bashkëpunojë. Sidomos, kemi pasur shumë punë me projektin e USAID dhe ky projekt është edhe 4 vitet e ardhshme, nëse nuk gabohe, për pesë vite, dhe drejtpërsëdrejti merret me bordet dhe realisht këta janë iniciatorë dhe fusim më pas diçka çfarë na duhet në agjendë. Mendoj se do të bëjmë një punë të mirë. Qëllimet e bordeve në fakultet janë puna e parë, me kurrikulën dhe programet studimore, pra ato të jenë në përputhje me atë çfarë kërkon tregu. Nëse ne kemi në një program që nuk i duhet tregut dhe këtu nuk gjejnë veten studentët atëherë nuk kemi bërë asgjë. Unë sa kam qenë në këtë pozitë jam munduar që programet t'i diskutojmë me bordet. Sidomos tani e kemi në akreditim një program, të hënën do të vijë raporti që të kalojë akreditimi, është programi Softëare Design Profesional. E kemi diskutuar disa herë me bordin dhe jemi munduar që të jetë një program në harmoni me nevojat e tregut. Bordi ka qenë pjesë e procesit të akreditimit ku e kanë mbrojtur. Njëri prej takimeve më të rëndësishme me ekspertët e akreditimit që e patëm më 26 mars ka qenë me bordin".

"Ideja e bordit është të bëhen sa më shumë vende të praktikës/punës, varet edhe nga suksesi i studentëve, me sa e vërejmë ne, suksesin e kanë të lartë, dhe sipas anketimeve që i kemi bërë, 70% e tyre punojnë në fushat ku kanë studiuar. Qëllimi është të rritet bashkëpunimi, të shkohet në punë praktike, me pagesë apo pa pagesë, meqë janë studentë aktualë".

"Çështja tjetër është e hulumtimeve. Bizneset kur e kanë një problem dhe dera e parë që duhet të drejtohen janë universiteteve, kështu është praktika në Evropë, drejtohet te universitetet ku ato gjejnë zgjidhje. Në Kosovë është pak a shumë e kundërta, ato drejtohet tek ekspertët jashtë Kosovës, oe mes vete si biznese gjejnë zgjidhje. Këtë frymë edhe projekti i USAID e ka qëllim, dmth ndërlidhjen mes universiteteve dhe sektorit privat. Qëllimi i bordit ndërlidhet me qëllimin e projektit.

Private Sector Partnerships to Strengthen Higher Education Activity is a USAID funded activity implemented by University of Iowa in partnership with Iowa State University and Kosova Education Center (KEC).



[Prezantim i pjesëmarrësve]

Anëtarët e rinj të Bordit Industrial të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike:

- Anesa Topko, Cactus Education
- Emin Krasniqi, Stree LLC
- Besfort Guri, Open Spatial Information Netëork
- Bellsid Bajrami, Selise Digital Platforms
- Luan Sopi, Competency Center, Prizren

Zirije Hasani: “Ju faleminderit të gjithëve për prezantimin! Falënderoj Enisin, Visarin dhe projektin që kemi një kompozicion të tillë të bordit dhe jam shumë e lumtur të ju shoh të gjithëve këtu. Uroj që bashkëpunimi ynë të jetë shumë i ngushtë dhe të bëjmë punë të mëdhaja për studentët, meqë ky është qëllimi kryesor. Tani do të kalojmë në pikën e udhëheqësisë së re të bordit, meqë do ta kemi kryetarin dhe zv. kryetarin, dmth ju vendosni [shpjegohet procedura e nominimit/votimit/zgjedhjes së kryetarit dhe zv. kryetarit të bordit në bazë të Rregullores për Themelimin dhe Funksionalizmin e Bordeve Industriale të Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti”.

Visar Haxhifazliu: “Do ta nominoja unë Enis Qafëleshin. Neve pak më shumë na ka rënë të bashkëpunojmë me Enisin në mandatin e kaluar dhe po besojmë që me punën që ka treguar ai, me profesionalizmin dhe seriozitetin, përderisa është angazhim vullnetar, po besoj që nuk ka asnjë hezitim, personalisht e po besoj universiteti edhe organizata që punën dhe seriozitetit që ka treguar Enisi që të vazhdojë edhe dy vite të tjera.

Getoar Krasniqi: “Ne si projekt nuk kemi të drejtë shumë të ndërhyjmë, mirëpo nga 5 projektet të cilat bashkëpunojmë, ky bord me të vërtetë e ka pasë udhëheqësinë më aktive. Përveç projektit ka shtyer edhe çështje të tjera. Interesi i projektit tonë është që të jetë një udhëheqës, mirëpo ky është qëllimi ynë, që të jetë një udhëheqësi që shtyen gjëra përpara dhe ne jemi asistues si projekt”.

Zirije Hasani: “A kemi ndonjë propozim tjetër, apo jo? [nuk ka përgjigje po apo jo]. Atëherë mendoj se mund ta nxjerrim në votim si procedurë, duke qenë se është vetëm një kandidatë, të gjithë keni të drejtë vote përveç meje. Kush është për që të zgjidhet Enis Qafëleshi kryetar i bordit? Konstatohet se Enis Qafëleshi zgjidhet me të gjithë votat pro kryetar i bordit!”.

Visar Haxhifazliu: “Po mendoj se Bellsidi mund të na ndihmojë, në rolin e zv. kryetarit”.

Bellsid Bajrami: “Këtu jemi plot, unë jam për, për cilindo që zgjidhet. Jam këtu për ta dhënë kontributin tim, kështu që, në çfarëdo sferë që mund të ndihmojë, unë jam për”.

Zirije Hasani: “Kush është për që Bellsid Bajrami, të zgjidhet zv. kryetar? [me të gjitha votat pro, votohet Bellsid Bajrami për zv. kryetar të bordit]. Konstatohet Bellsid Bajrami zv. kryetar i Bordit Këshilldhënës Industrial në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike”.

[Nënshkruhen marrëveshjet e mirëkuptimit mes bordit dhe fakultetit për anëtarët e rinj të bordit].

Enis Qafëleshi: “Faleminderit për besimin! Është mirë që të rifreskohen pozitat, dhe fatmirësisht që rregullorja nuk i lejon më shumë se dy mandatate dyvjeçare, kjo është mirë. Ardhja e ITP-së dhe fatmirësisht

gjuha e përbashkëet e ITP-së me palët tjera, ka bërë që të ketë një impakt të fuqishëm në punët tona, sado që sfidat janë të njohura, por janë hapur disa vende të reja të punës, edhe për studentët edhe për të rinjtë. Ndonëse nevoja për të sjellë energjit të reja është gjithmonë, ka nevojë të ketë edhe konsistencë. Në e-mail do t'ua dërgoj planin e punës, ndoshta nuk ka qenë aq edhe komplikuar të ëhet një plan, duke qenë se anëtarët e bordit ndryshojnë, edhe derisa vijnë anëtarët e rinj dhe adoptohen me bordit dhe çfarë roli ka bordi, parashihet që bordi të jetë aktiv, pra që të mos jemi me atë logjikë, pra mos të jenë pasivë dhe nëse ka ide për ndryshime ato janë gjithnjë të mundshme.

Puna jonë është vullnetare këtu, nuk është që dikush na sjellë me vështirësi. Nëse në një moment të caktuar, dikush nga anëtarët e sheh se nuk po mundet, jo 1 herë-2 herë, edhe pse rregullorja i ka disa precizimi, por nëse e sheh se nuk mund të jetë është mirë të na njoftojë për largimin e tij. Ju keni kompani ose përfaqësoni kompani, dhe shiheni bordin jo si kompania të jetë direkt përfituese, por edhe shoqëria përfituese, pra të dyjat bashkë në kuptim të kapaciteteve, zgjerimit të hulumtimeve dhe pikave të përbashkëta që i ka synim bordi. Kjo nënkupton që organizata, kompania që e përfaqësojme ne, duhet të jetë ngushtë e lidhur me universitetin dhe të kemi mirëkuptim. Unë mendoj se organizatat rinore të orientuara nga trajnimet, ndërmarrësia e re, mund të jenë profile që mund të jenë të mirëseardhura. Ne të mendojmë se si edhe të tjerët mund të përfitojnë, psh nga fusha e marketingut digjital, tech support, gjeografisë informative, sistemeve apo të ngjashme. Ta shohim mundësinë se si t'i zhvillojmë bashkë edhe anëtarët tjerë të profileve tona që nuk janë.

Komponimi i këtij bordi është se secili e kemi një specialitet të ndryshëm, në profilet tona, kështu që ta shohim se si e kemi mundësinë ta zgjerojmë këtë kapacitet. Ne i dimë trendet, i njohim trendet por mos të ngecim prapa me zhvillimet hovshme AI, Data Sciece që nuk po mundemi me i prek shumë si industri por studentëve të ju jepet mundësia të paktën të jenë të suksesshëm në hulumtime. E di se plani i punës do të duhet të jetë i vendosur në letër, por gjithmonë do të jenë të mirëseardhura idetë e reja dhe në takimin tjetër që do ta mbajmë në tremujorshin e radhës, të mendojmë se si ta pasurojmë dhe çfarë mund të shtojmë apo të ndryshojmë. Kur të japim ide gjithmonë të jem të afërt me mundësitë e realizimit, kapacitetet, kushtet por edhe me pyetjet, meqë dekanatet, studentët duhet të jenë pjesë e bordit. Ne gjithmonë do të pyesim se cilat janë mundësitë e kapacitetet, por edhe projekti i IOËA-s e ka një komponentë edhe objektiva shumë të fuqishme të cilat po besoj mund të jenë për neve orientim se në çfarë drejtimi mund të punohet”.

Zirije Hasani: “Jemi në fazën e dokumenteve shtesë, ajo kaloi shumë lehtë, aty vërehet si ka qenë feedback-u, rreth procesit të akreditimit të Softëare Design Professional”.

Emin Krasniqi: “A ka ndonjë ndryshim esencial: pra ndryshime esenciale në raport me versionit fillestar të vitit 2010?”

Zirije Hasani: “Ajo është 100% e ndërruar, sepse më parë keni pasë më shumë lëndë të tepërta nga ekonomia. Krahasuar me atë që ka qenë në vitin 2010 është 100% më ndryshme, krahasuar me atë që ka qenë me vitin 2022, është 50% më ndryshme. Shumë lëndë të reja janë shtuar, më shumë fokusohemi programimit në punë, praktikës, janë larguar lëndët më hulumtuuese, është fokusuar më shumë te programimi: psh është shtuar Python ose Data Science”.

[Getoar Krasniqi, prezanton dokumentin e rezultateve të arritura të Private Sector Partnership to Strengthen Higher Education]

PRIVATE SECTOR PARTNERSHIPS TO STRENGTHEN HIGHER EDUCATION

Enis Qafëleshi: “Nga idetë e punës i kemi edhe disa vizita. Mund të bëhet një google feed back form prej studentëve, se sa ka qenë efektiv/ ose iu ka pëlqyer atyre vizita, me 2-3 pyetje fillimisht, të cilat më vonë mund të pasurohen”.

Getoar Krasniqi: “Me klubet e studentëve mund të kontribuojmë në aktivitetet e përmendura nga pjesëmarrësit, në organizimet e ITP-së/universitetit. Ne e kemi përfaqësuesin e studentëve në universitet por nuk pati mundësi të vijë sot, por e kemi diskutuar shumë më herët që do të marrin pjesë në aktivitete në të mirë të klubit e për të bashkëpunuar me studentë për ta arritur aktivizimin e tyre, dhe rritur numrin e tyre. Do të mund të bashkëpunonim edhe me klubin e studentëve në Prishtinë dhe marrë të dhëna nga ju se si mund t'i aktivizojmë studentët?”.

Visar Haxhifazliu: “Në të premtën e ardhshme, pra 19 prill 2024, parashihet që të mbahet një takim ku do të diskutohet me të gjithë anëtarët e konsorciumit në ITP. Kushdo që mund të vijë me një ide a propozim do të mund të vijë atë ditë në takim dhe të diskutojë veçanërisht”.

Pikat e veprimit

Task	Responsible	Deadline	Comments
Dërgimi i Planit të Punës të Bordit Industrial të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike te anëtarët e Bordit Industrial	Enis Qafëleshi	Fundi i muajit prill	
Dërgimi i raportit për temat prioritare për hulumtim dhe ekspertizë në fushën e ICT, 2024.	Getoar Krasniqi	15 prill 2024	

Vendimet e marra

- Enis Qafëleshi është zgjedhur kryetar i Bordit Industrial të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike
- Bellsid Bajrami është zgjedhur zv. kryetar i Bordit Industrial të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike

Takimi i radhës

Planifikohet që takimi i radhës të mbahet në tremujorin e ardhshëm: përafërsisht në muajin qershor.

PRIVATE SECTOR PARTNERSHIPS TO STRENGTHEN HIGHER EDUCATION

 Përmbledhje e diskutimit e përgatitur nga: Denur Paçaku

 Data: 13.04.2024

 MPërmbledhja e diskutimit aprovuar nga: Getoar Krasniqi

 Date: 13.04.2024

Lista e pjesëmarrjes:



The document is a printed form titled "Participants List" for an "Industrial Board Meeting" held on "11 April 2024" at the "Salla e Senatit - Faculty of Life Sciences and Environment, University of Prizren". It features logos for USAID, the University of Prizren, and IOWA. A QR code is present on the left side. The main content is a table with five columns: Name and Surname, Position/Affiliation, Institution, Email Address, and Signature. The table lists seven participants with their respective roles and contact information. Handwritten signatures are provided for each participant. At the bottom, there is a footer with logos for Iowa State University and KEC (Kosova Education Center), along with a page number "Page 1 of 3".

Name and Surname	Position/Affiliation	Institution	Email Address	Signature
Zirje Hasani	Dean	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike - UPZ	zirje.hasani@umi-prizren.com	Zirje H.
Enis Qafelesi	Executive Director	Makerspace	enis@makerspacepr	Enis Q.
Visar Haxhifazliu	Digitization Advisor	GIZ - ITP	visar.haxhifazliu@iz.de	Visar H.
Lulzim Guhelli	Project Manager	Ex-Cite		Lulzim G.
Fatos Dida	Engineer	Proton Cable		Fatos D.
Emin Krasniqi	Executive Director	Stree LLC	emin@stree.agency	Emin K.
Besfort Guri	Executive Director	Open Spatial Information Network	besiguri@gmail.com	Besfort G.

The Private Sector Partnerships to Strengthen Higher Education Activity is a USAID funded activity implemented by University of Iowa in partnership with Iowa State University and Kosova Education Center (KEC).

IOWA STATE UNIVERSITY 

Page 1 of 3

Private Sector Partnerships to Strengthen Higher Education Activity is a USAID funded activity implemented by University of Iowa in partnership with Iowa State University and Kosova Education Center (KEC).



PRIVATE SECTOR PARTNERSHIPS TO STRENGTHEN HIGHER EDUCATION



PRIVATE SECTOR PARTNERSHIPS TO STRENGTHEN HIGHER EDUCATION

Participants List
Industrial Board Meeting

11 April 2024, Salla e Senatit – Faculty of Life Sciences and Environment
University of Prizren



Anesa Topko	Business Development Manager	Cactus Education	anesa.topko@cactus.education	
Bellsid Bajrami	Manager	Selise Digital Platforms	bellsid.bajrami@selisegroup.com	
Esen Kamakci	Director	Eris Agensi	esenkamakci@yahoo.com	
Luan Sopi	Vice-Director	Competency Center Prizren	luan.sopi@kec.edu.kos	
Asdren Pervizaj	Student Representative	Faculty of Computer Science		

Private Sector Partnerships to Strengthen Higher Education Activity is a USAID funded activity implemented by University of Iowa in partnership with Iowa State University and Kosova Education Center (KEC).

